

STILI

Balanca

Balanca përfshin skema që trajtojnë *paralelizmin, antitezën, klimaksin*, e të tjera.

Antiteza

grc. ἀντίθεσις antíthesis ‘antitezë’; anti ‘kundër’ + tezë ‘me vü; *me përspjekë* (dý idé). Në këtë figurë, pransohen dý fjalë ose idé. Pjesët e pransuome kanë strukturë paralele me njëna-tjetrën. Një shembull tipik i kësaj figure është thanja e kozmanautit amerikan Niel Armstrong kur ai zbriti në Hanë në vitin 1969:

*...një hap **i vogël** për njeriun,*

*një behdije **gjigande** për njerzimin.*

Këtu ‘i vogël’ është antiteza e ‘gjigande’; vogëlsia përspiqet me gjiganden.

Shembuj të tjerë:

Me qenë a mos me qenë, ajo është çashtja. (Shekspiri, Hamleti)

Këtu antiteza e ‘me qenë’ është ‘mos me qenë’.

Me gabua është njerzore, me falë është hyjnore (Aleksandër Pope)

Gabimi nënkupton ‘dënimin’; falja nënkupton ‘mosdënimin’.

Paralelizmi

Kjo skemë përdoret me pendsua dý a më shumë fjalë, fraza, a klauza.

1. paralelizmi i **fjalëve**: *Diella foli shpejt, shkurt, dhe qartë.*

Kur fjalët i përkasin të njëjtës pjesë të ligiratës dhe kanë të njëjtën trajtë, ato formojnë strukturë paralele. Po të ndërrohej njëna sosh, do të prishej paralelizëmi, p.sh. *Diella foli me shpejtsí, shkurt, dhe qartsisht*. Prejse kësaj fjalie i mungon paralelizmi, ajo i ngjason një udhtimi në një rrugë gropa-gropa.

2. paralelizmi i **frazave**: *Duke lexua shpejt, duke marrë shënime të përpikëta, dhe duke shkrua pa gabime, Diella e mbaroi sprovën para rogut.*

Në këtë fjalí, të trí shprehjet kanë strukturë përcjellore. Sikur kjo strukturë të prishej, fjalia do të tingëllonte jo-shtruet, p.sh., *Diella kishte lexua shpejt, mandej pati marrë shënime të përpikëta, dhe duke shkrua pa gabime*, e mbaroi sprovën para rogut.

3. paralelizmi i **klauzave**: *Diella lexoi një tregim, Prela shkroi një artikull, dhe Filja bani detyrat e shtëpisë.*

Këto tri klauza sundohen prej foljesh ne të kaluomen e thjeshtë, ku tregohet që të gjitha veprimet janë të kryeme, dhe, prej rrethanave kumtore lexuesi e din se flitet për një familje.

Ka edhe herë kur dëshirohet me tregua që ndërsa dikush po kryente një veprim, dikush tjetër përfundoi një veprim tjetër, por në fjalinë e masipërme, trajtat zgjedhimore e lakimore duhen ruajt, përndryshe, fjalia mund të tingëllonte e parregullt, p.sh., *Diella kishte lexuom një tregim, Prela po shkruante një artikull, dhe Filja bani detyrat*. Në këtë fjalí, nuk dihet se si veprimet e këtyne personave lidhen në kohë e hapsinë. Kjo fjalí tingllon si një zigzag¹.

4. Paralelizmi i fjalive. “**Vesi** i trashëguom i kapitalizmit është racionalizimi joproportional i bekimeve; **virtyti** i trashëguom i socializmit është racionalizimi proporcional i mjerimeve.” (W. Churchill).

Krahasoje paralelizmin gramatik; formën:

vesi i trashëguom i kapitalizmit është racionalizimi joproportional i bekimeve;

virtyti i trashëguom i socializmit është racionalizimi proporcional i mjerimeve.”

Deformimi i formës do të deformonte kuptimin, p.sh.,

vesi i trashëguom i kapitalizmit është racionalizimi joproportional i bekimeve;

virtyti që trashëgon socializmi është racionalizimi i proporcionalizumu i mjerimeve.”

Isokolona

Në këtë skemë paralelizimi, *artikujt* që formojnë strukturën paralele, mund të jenë fraza, klauza, e fjalí. Tipikisht, ata kanë të njëjtin gjatsí. Në perdorime mã specifike, ata mund të kenë edhe të njëjtin numër rrokjesh.

bikolona (*dy artikuj*): *Blej një; merr një falas.*

trikolona (*tre artikuj*): *Erdha, kqyra, mora!*

tetrakolona (*katër artikuj*): Shekspiri, Richardi II^{te}

Unë do të jap bizhuteritë e mia për një varg rruazash,

Pallatin tim të mrekullueshëm për një banesë hermitit,

Petkat e mija të shëndritëshme për veshjen e një lypsit,

Kupat e mia me figura për një pjatë drunit.

¹ tingëllon si një zigzag - Kjo është figura e sinesthezisë, ku një shqisë përshkruhet në termat e një shqisë tjetër, p.sh., shqisa e dëgjimit (tingëllonte) në termat e shqisës së shikimit (zigzag).

Klimaksi

grc. κλίμαξ, klimaks ‘shkallë’

Shpesh duke ruajt strukturë paralele, fjalët, frazat, ose klauzat renditen sipas ngritjes së randësisë, duke e shtý artikullin e fundit në sosje.

shkallzimi ngjitës: Stalinizmi refuzoi *pleqtë e ligjit, vojvodët, flamurtarët* dhe *të gjith sistemin ligjor* që shqiptari authetik e pati ruajtun me gjak për shekuj të tanë.

Antiklimaksi

Antiklimaksi nisë si klimaksi; secili artikull pasohet prej një artikulli më të randësishëm—deri te artikulli i fundit, i cili në vend që me u ngritë në randsí dhe me formua kulmin e vargimit, ulet në randsí nën vlerën e të gjith artikujve që vinë para tij. Ky efekt mund të përdoret me krijua situata komike. Kur ai merret seriozisht, lexuesi ndjehet i zhgënjyem.

Shembull zhgenjimi: *Qysh në vogli, ai u stërvit në përdorimin e shpatës, në moshë shum të ré u bë pjestar e trupave speciale, kur ishte 18 vjeç u dërgua në luftë për çlirimin e popujve të shtypun, ku u mësua në droga dhe përfundoi si lypës.*

Katakosmeza

Në këtë figurë, artikujt renditen prej më të randësishëmit te më pak i randësisheme, p.sh.,

shkallzimi zbritës: *Dielli, toka, dhe hana mundsojnë egzistencën e njeriut.*

Krahasoje me shkallzimin ngjitës: *Hana, toka, dielli...*